

## **Raport Teknik per objektin**

### **Nderhyrje për përmirësimin e shtresave rrugore ne te gjithë territorin e Shqiperise**

#### **Përshkrimi i përgjithshëm i projektit**

Gjate rikonjiconit ne terren dhe vezhgimeve te hollesishme nga stafi i FSHZH eshte vene re se ne disa akse rrugore ka segmente ku shtresat ekzistuese te rrugeve jane te demtuara. Gjendja ekzistuese e shtresave rrugore nuk garanton kerkesat dhe standartet ne fuqi dhe ne pjesen dermuese te ketyre rrugeve kane dale jashte kushteve teknike te projektimit.

Nëpërmjet kësaj ndërhyrje parashikohet përmiresimi I shtresave asfaltike dhe i shtresave te bazes dhe nenbazes ne disa prej akseve rrugore te rendesishme. Kjo ne funksion te permiresimit të aksesit ne zona turistike e ekonomike ne perputhje dhe komplementare me programet e zhvillimit rajonal, programi 100 F etj.

#### **Përshkrimi teknik i projektit**

Permiresimi I qarkullimit dhe levizshmerise perben nje nder nderhyrjet kryesore qe parashikohet te behet ne kuader te ketij komponenti. Ky permiresim parashikon tre kategori nderhyrjesh ne trupin e rruges:

- i. Frezim, Trajtim/riparim pjesor me stabilizant, binder 6cm+tapet 4cm
- ii. Frezim, profilim me binder, tapet 4cm
- iii. Frezim, Tapet 4 cm

Ne segmentet ku do te nderhyet do verifikohet ne vend gjendja aktuale e rruges dhe lloji dhe siperfaqja e nderhyrjes ne bashkepunim me stafin teknik te FSHZH.

#### **Vendodhja e objektit**

FSHZH ka pregatitur nje liste paraprake me rruge ne te cilat parashikohet te nderhyet per permiresim te shtresave rrugore ne rajonin 1 dhe 3. Me ane te ketij programi do te mundesohet trajtimi i disa prej ketyre akseve/seksioneve rrugore, bazuar ne fondin e parashikuar per kete qellim.

#### **Impakti i investimit**

- Përmirësim i aksesit dhe funksioneve te rrugeve rajonale e lokale me kosto te ulet

investimi.

- Përmirësim i cilësisë së jetës së banorëve të zonës.
- Përmirësim i shërbimeve komunitare.
- Përmirësim i sigurisë rrugore,

### **Siguria dhe shëndeti në punë**

Gjatë zbatimit të punimeve duhet të respektohen me rigorozitet të gjitha kërkesat për sigurinë dhe shëndetin në punë në përputhje me legjislacionin në fuqi, kushtet teknike si dhe praktikën më të mirë.

I gjithë personeli duhet të jetë i trajnuar në lidhje me sigurinë dhe shëndetin në punë përpara se të hyjë në kantonier. Drejtuesit e makinerive të ndërtimit duhet të jenë të pajisur me certifikatat dhe lejet përkatëse të drejtimit. Duhet bërë rrethimi dhe mbrojtja e kantonierit në zonat ku do kryhen punime.

### **Specifikime teknike**

#### **• Punimet e germimit**

Punimet e germimit do të fillojnë pasi të jetë bërë përkthimi në përputhje me planet e germimeve si dhe azhurnimi dhe verifikimi i sistemeve ekzistuese nëntokësore. Për germimin do të përdoren makineri të përshtatshme (eskavatore, buldozere, kamione)

Makineritë do të përdoren vetëm nga personel i specializuar dhe i pajisur me lejet përkatëse të drejtimit. Materiali i dalë nga germimet i cili nuk do të përdoret si material mbushës do të depozitohet në vendet e miratuara nga Autoritetet përkatëse.

Ky zë është parashikuar të kryhet me makineri dhe transport me auto. Pas arritjes në kuotë të bëhet profilimi dhe rrulimi i tabanit ekzistues me rrul vibrues (dinamik). Mbeturinat të largohen me automjet.

#### **Punimet e Shtresave**

Shtresë çakëlli makinerie

Çakëlli i makinerisë është material me përbërje granulometrike 20-50mm dhe pas hapjes në objekt, bëhet ngjeshja me rrul vibrues. Shtresa e çakëllit ka një trashësi prej 20cm

dhe duhet të laget paraprakisht, pastaj bëhet ngjeshja me rrul. Shtresa duhet të jetë tërësisht e pastër, pa përmbajtje dherash apo material të tjera.

Shtresë çakëlli mbeturinë kave

Indeksi i plasticitetit nuk duhet të kalojë 10

Nuk duhet të përmbajë grimca më të mëdha se  $\frac{2}{3}$  e shtresës, në sasi mbi 5%.

Nuk duhet të përmbajë mbi 10% grimca argjilore. Kjo shtresë duhet të miratohet nga inxhinieri pas kontrollit të kasonetës. Ngjeshja me 1 kalim do të jetë 150mm

Sipërfaqja e përfunduar, e ngjeshur nuk duhet të kalojë  $\pm 20\text{mm}$ .

Shtresë stabilizanti

Ky material është gur i thyer fraktoje, me granulometrinë 0.5-20mm. Shtresa ka trashësinë prej 10cm, ngjeshet me rrul vibrues dhe laget me ujë për të përfutur një ngjeshmëri më të mirë. Lagia me ujë e kësaj shtrese do të vazhdojë edhe pas ngjeshjes, për të mos ndotur zonën me pluhur.

### **Shtresë Asfalto Betoni ( Binder dhe Asfaltobeton)**

Në këtë zë është parashikuar spërkatja me bitum 1-2 litra/m<sup>2</sup>, transporti, shtrimi me makineri dhe ngjeshja ne rrul. Shtresa e binderit, pas rrulimit, të ketë trashësinë prej 6cm. Materialet e prodhimit të jenë brenda standarteve. Provat të merren me mostra 25x25 për çdo 500m<sup>2</sup> asfalt të shtruar, dhe të provohen në laborator për treguesit fiziko-mekanik, të cilët duhet të jenë brenda kërkesave të STASH 660-87. Gjatë shtrimit të shtresave asfaltike, të kihet parasysh kërkesat teknike dhe të mbahet akt kontrollit teknike, ku të pasqyrohen të gjitha të dhënat si: pamja, matjet laboratorike, pastërtia e nënshtresave dhe spërkatja me bitum. Trashësia e shtresës së asfaltobetonit në momentin e shtrimit (në gjendje të shkrifet) duhet të jete 1.20 deri 1.25% me shume nga trashësia e dhene ne projekt zbatim ne gjendje te ngjeshur. Shtresa e asfaltit të ketë pas ngjeshjes trashësinë prej 4cm, dhe ajo e binderit 6cm. Ngjeshja e asfalto betonit quhet e perfunduar atehere kur mbi siperfaqen e asfaltuar cilindri gjate kalimit te tij nuk le me gjurme.